

Gjitari më trupmadh

Ariu i murrmë (*Ursus arctos*) është gjitari më i madh që gjendet në Shqipëri. Meshkujt e këtij lloji arrijnë një peshë prej 170-190 kg, ndërkohë që femrat nuk i kalojnë 160 kg.

Në Shqipëri gjenden 180-200 individë të ariut të murrmë duke e bërë këtë lloj të listohet si vulnerabël (VU) në Listën e Kuqe të Florës dhe Faunës së Shqipërisë. Ariu i murrmë gëzon mbrojtje ligjore të plotë, duke përfshirë ligjet kombëtare, ku ndalohet rreptësisht gjuetia e këtij lloji, si dhe konventat ndërkombëtare për ruajtjen e natyrës që Shqipëria ka ratifikuar.



Ligji Nr. 10006, 2008
“Për mbrojtjen e faunës së egër”

Ligji Nr. Nr. 10253, 2010 “Për gjuetinë”

Direktiva Europiane të Habitaveve
(Aneks II & IV)

Konventa Ndërkombëtare për
Tregtinë e Llojeve në Rrezik (CITES)

Sjellja

Arinjtë tregojnë sjellje vetmitare, duke zënë terriore nga 50-200 km². Megjithatë, arinjtë komunikojnë me njëri-tjetrin nëpërmjet shënjimit të terrioreve me urinë dhe sekrecione.

Individët e këtij lloji afrohen me njëri-tjetrin gjatë periudhës së çiftimit, që përkon me stinën e verës, ndërkohë që të vegjlit lindin gjatë periudhës së dimrit.

Ky lloj strehohet në zona pyjore të dendura e të pafragmentuara, ku ushqehet kryesisht me produkte bimore, si fruta pylli, etj., ku ndihmojnë edhe në përhapjen e farave.



mund të lindin 1-4 këlyshë, zakonisht 2 këlyshët e sapolindur: < 1 kg, dhe nuk janë në gjendje të shikojnë.



Gjithashtu, arinjtë ushqehen edhe me këрма, duke ndihmuar në parandalimin e përhapjes së infeksioneve të ndryshme.

Përse ariu është i rrezikuar?



Pavarësisht mbrojtjes ligjore, arinjtë përballen me një mori kërcënimesh, që vijnë kryesisht si pasojë e aktivitetit të njerëzve, ku mund të përmendim gjuetinë e paligjshme, shkatërrimin dhe prerjen e pyjeve, apo mbajtjen në kaptivitete për qëllime ekspozimi.



Si mund t'a dalloni praninë e arinjve në natyrë?



Prania e strofullave

Shenja kthetrash në pemë

Jashtëqitjet e ariut mund të dallohen nga ushqimet e patretura mirë, nga të cilat studiuesit kuptojnë dietën ushqimore të këtij lloji.

Gjurmë në baltë dhe/ose dëborë.



putra e përparme

5 kthetra

10 - 15 cm



putra e pasme

Për adhuresit e jetës së egër, prania e arinjve në një ekosistem bën që ky i fundit të perceptohet si i pasur dhe me vlerë për tu vizituar.

Në zona me biodiversitet të lartë në vendin tonë, komunitetet lokale mendojnë se prania e arinjve është një ogur i mirë për zhvillimin e turizmit natyror.



Nëse shikon një ari të mbajtur në kaptivitet, ju lutemi të informoni ekipin e PPNEA në numrin +35545628954, ose në adresën e email-it contact@ppnea.org


Skano këtu për t'u bërë pjesë e përpjekjeve për ruajtjen e popullatës së arinjve të murrmë në Shqipëri.



In partnership with



Supported by



Ajencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Funded by the European Union



Embassy of the Federal Republic of Germany Tirana



ARIU I MURRMË

Gjitari më trupmadh në Shqipëri



Albania is Biodiversity